"O i Dërguari i Allahut, nuk kam lënë asnjë gjynah të vogël e të madh pa e kryer." Ai i tha: "A nuk dëshmon se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut që meriton adhurimin dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut?

Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: Një burrë erdhi te Profeti ﷺ dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, nuk kam lënë asnjë gjynah të vogël e të madh pa e kryer." Ai i tha: "A nuk dëshmon se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut që meriton adhurimin dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut?" Ai e përsëriti pyetjen tri herë. Ai iu përgjigj: "Po." Kështu, Profeti ﷺ i tha: "Kjo i mund (shlyen) ato."

[Sahih] [Transmetojnë Ebu Jala, Taberaniu dhe Ed-Dija El-Makdisiu]

Një burrë erdhi te Profeti ﷺ dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, unë i kam bërë të gjitha mëkatet dhe nuk kam lënë pa bërë asnjë mëkat të vogël e as të madh! A më falen mëkatet? Profeti ﷺ i tha: "A nuk dëshmon se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut që meriton adhurimin dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut?" Këtë ia përsëriti tri herë. Ai u përgjigj: "Po." Profeti ﷺ ia tregoi vlerën e shehadetit: se ai i shlyen të këqijat dhe se pendimi i shlyen gjynahet e kaluara.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/65006